

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

# RAPORTI VJETOR 2017



**PRIVATËSI**

**TRANSPARENCË**

**INFORMIM**

**PROGRAM**



[www.idp.al](http://www.idp.al)

## **PËRMBAJTJA**

|                                                                                                               |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1. VËSHTRIM MBI VITIN 2017 .....</b>                                                                       | <b>4</b>  |
| <b>2. E DREJTA E INFORMIMIT .....</b>                                                                         | <b>5</b>  |
| 2.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” .....                       | 5         |
| 2.2 Trajtimi i ankesave .....                                                                                 | 8         |
| 2.3 Hetime administrative .....                                                                               | 9         |
| 2.4 Strategji dhe indikatorë .....                                                                            | 10        |
| 2.4.1 Strategjia Ndërsektorale për Reformën në Administratën Publike .....                                    | 10        |
| 2.4.2 Kontrata Sektoriale e Mbështetjes Buxhetore për Reformën në Administratën Publike .....                 | 11        |
| 2.4.3 Strategjia Ndërsektorale Antikorrupsion .....                                                           | 12        |
| 2.5 Bashkëpunime .....                                                                                        | 13        |
| 2.5.1 Bashkëpunimi me Projektin Star 2 të UNDP .....                                                          | 13        |
| 2.5.2 Bashkëpunimi me ASPA .....                                                                              | 13        |
| <b>3. E DREJTA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE .....</b>                                                  | <b>13</b> |
| 3.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ..... | 13        |
| 3.2 Trajtimi i ankesave .....                                                                                 | 14        |
| 3.3 Hetimet administrative .....                                                                              | 15        |
| 3.4 Rekomandime dhe Urdhra .....                                                                              | 17        |
| 3.5 Sanksione administrative .....                                                                            | 18        |
| 3.6 Njoftimi .....                                                                                            | 19        |
| 3.7 Transferimi ndërkombëtar .....                                                                            | 19        |
| <b>4. VEPRIMTARIA LIGJORE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE ....</b>                                   | <b>20</b> |
| 4.1 Hartimi i akteve rregullatore .....                                                                       | 20        |
| 4.2 Dhënie mendimi për projekt/akte .....                                                                     | 21        |
| 4.3 Detyrime që burojnë nga akte të tjera ligjore .....                                                       | 22        |
| 4.4 Monitorimi i Fletoreve Zyrtare .....                                                                      | 23        |
| 4.5 Proceset gjyqësore .....                                                                                  | 23        |
| 4.6 Raportime .....                                                                                           | 25        |
| <b>5. TRAJTIMI I ANKESAVE SIPAS LIGJIT NR. 146/2014 “PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK” .....</b>          | <b>26</b> |
| <b>6. NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE .....</b>   | <b>27</b> |
| <b>7. VEPRIMTARIA NDËRKOMBËTARE .....</b>                                                                     | <b>31</b> |
| <b>8. MENAXHIMI BUXHETOR .....</b>                                                                            | <b>33</b> |
| <b>9. PROBLEMATIKAT PËR VITIN 2017 .....</b>                                                                  | <b>36</b> |
| <b>10. PRIORITETET PËR VITIN 2018 .....</b>                                                                   | <b>37</b> |

|                       |           |
|-----------------------|-----------|
| <b>ANEKSI 1 .....</b> | <b>38</b> |
| <b>ANEKSI 2 .....</b> | <b>44</b> |
| <b>ANEKSI 3 .....</b> | <b>46</b> |

## 1. VËSHTRIM MBI VITIN 2017

Hartimi i këtij raporti bazohet në analizën e performancës institucionale për vitin 2017 të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), lidhur me monitorimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe të trajtimit të ankesave lidhur me ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit mbështetet në zbatimin me korrektësi të legjislacionit shqiptar, të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe detyrimeve që burojnë nga bashkëpunimi ndërkombëtar. Për Zyrën e Komisionerit viti 2017 ka qenë një vit dinamik, me një veprimtari të zgjeruar, kontribute të prekshme, përgjegjësi dhe sfida të reja.

Në kuadër të të drejtës për informim, Zyra e Komisionerit konstaton progres në rritjen e vetëdijes së Autoriteteve Publike për detyrimet e tyre mbi transparencën dhe dhënien e informacionit publik proaktiv. Mbetet ende problem për autoritetet publike aksesin i qytetarëve në informacionin me kërkesë si dhe respektimi i afateve ligjore. Qytetarët gjithashtu kanë vazhduar të tregojnë besim në zbatimin e të drejtës së tyre për informim, duke u adresuar me ankesa të shumta pranë Zyrës së Komisionerit, për rastet ku pretendojnë se iu është mohuar kjo e drejtë.

Në kuadër të të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit është angazhuar në monitorimin e përpunimit të të dhënave personale dhe mbikëqyrjen e respektimit të masave të sigurisë gjatë përpunimit të tyre, nga kontrollues publik dhe privatë. Si rrjedhojë, Zyra e Komisionerit ka pasur një rritje të vazhdueshme të numrit të ankesave. Kompleksiteti i ankesave të mbërritura në adresë të Zyrës së Komisionerit dhe hetimet e shumta administrative janë dëshmi e zhvillimit pozitiv që e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale po merr dita ditës edhe në Shqipëri.

Me gjithë rritjen e ndjeshmërisë së qytetarëve për të drejtën e tyre për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale si dhe angazhimin e Zyrës së Komisionerit për të zbatuar me korrektësi legjislacionin në fuqi dhe standartet evropiane, mbetet ende sfiduese vendosja e balancës midis të drejtës për informacion publik dhe mbrojtjes së privatësisë, në veçanti në rastet kur këto dy të drejta duhen balancuar dhe me lirinë e shprehjes.

Zyra e Komisionerit është gjithashtu e angazhuar në trajtimin e ankesave mbi zbatimin e ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” për të cilat është shprehur me vendime të rëndësishme. Mbetet ende punë për t’u bërë, sidomos për ndërgjegjësimin e qytetarëve në ushtrimin e të drejtës së tyre për t’u njoftuar dhe konsultuar me projektligjet, projekt dokumentat strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.

## 2. E DREJTA E INFORMIMIT

Aksesi në informacionin që prodhohet apo mbahet nga autoritetet publike është i një rëndësie thelbësore për mirëqeverisjen dhe demokracinë. Refuzimi i aksesit në informacion publik, cënon të drejtat e individëve për të krijuar pikëpamjen e duhur mbi shtetin dhe situatën e shoqërisë, sikurse parashikohet në nenin 1, pika 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Transparenca e administratës publike është një parakusht i domosdoshëm për një shtet të hapur dhe demokratik si dhe për forcimin e shtetit të të drejtës. Njëkohësisht, transparenca ecën paralelisht me integritetin dhe llogaridhënien e organeve të sektorit publik, parashikuar në Nenin 1, pika 3, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.


### 2.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Gjatë vitit 2017, Zyra e Komisionerit ka vijuar punën lidhur me zbatimin dhe monitorimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kryhet nëpërmjet monitorimit të elementëve të ndryshëm të ligjit si p.sh. numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinatorë të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna.

Gjatë vitit 2017, Zyra e Komisionerit jo vetëm ka monitoruar faqet zyrtare të Autoriteteve Publike, por ka kryer inspektime në terren si dhe ka kërkuar informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 119/2014, si:

- publikimi i programeve të transparencës;
- caktimi i koordinatorit për të drejtën e informimit;
- publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

Nga monitorimi i autoriteteve publike ka rezultuar se **181** autoritete publike kanë miratuar dhe kanë bërë publik programin e transparencës; **227** autoritete publike kanë caktuar koordinator për të drejtën e informimit dhe **124** Autoritete Publike kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.



Nga monitorimi i autoriteteve publike për vitin 2017 ka rezultuar se institucionet të cilat kanë një program të plotë dhe të përditësuar transparence janë ***institucionet e pavarura***. Gjithashtu, institucionet e pavarura, kanë të njëjtët koordinator që kanë caktuar që me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”. Numri i kërkesave për informim të trajtuara nga këto institucione, gjatë vitit 2017 është **1303**, ndërsa numri i kërkesave të refuzuara **98**.

Në lidhje me pushtetin vendor, Zyra e Komisionerit vlerëson se niveli i transparencës së ***bashkive*** shënon përmirësime. Tashmë të gjitha bashkitë kanë caktuar koordinatorët e të drejtës për informim dhe numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nga bashkitë gjatë vitit 2017 është **9308**, ndërsa numri i kërkesave të refuzuara është **245**.

Disa nga problematikat që hasen në institucionet e ***pushtetit vendor*** janë:

1. Disa bashki nuk zotërojnë një faqe interneti, çka sjell vështirësi në aksesimin e informacionit;
2. Disa bashki të cilat edhe pse zotërojnë një faqe interneti nuk kanë të publikuar apo përditësuar programin e transparencës dhe regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Gjithashtu, një pjesë e materialeve të publikuar në programin e transparencës nuk janë të linkuara;
3. Konstatohet se ikona e programit të transparencës nuk është ikonë parësore e vendosur në faqen e internetit;

4. Edhe pse të gjitha bashkitë kanë caktuar koordinator për të drejtën e informimit dhe kanë njoftuar Zyrën e Komisionerit me anë të një shkrese zyrtare, të dhënat e koordinatorëve, të publikuara në faqet e internetit, nuk janë të plotë.

Më problematike situata e transparencës ka qenë për **institucionet e pushtetit qendror**. Edhe pse pati përmirësime të dukshme 6 mujorin e parë të vitit 2017, referuar monitorimit, sipas të cilit të gjitha ministrinë kishin caktuar koordinatorë të të drejtës për informim dhe programet e transparencës, kjo situatë pati ndryshime pas muajit qershor për shkak të zgjedhjeve elektorale si dhe ndryshimit të kabinetit qeveritar. Ndryshimet konsistuan si në numër të ministrive ashtu edhe në fushat e kompetencave të secilës ministrie. Për rrjedhojë, pati një përkeqësim të dukshëm lidhur me zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji “Për të drejtën e informimit”. Në një pjesë të ministrive pati ndryshim të koordinatorëve të të drejtës për informim, në faqet e internetit të ministrive të reja ekzistonte një ikonë fiktive për programin e transparencës.

Problematikat e konstatuara lidhur me nivelin e transparencës së **ministrive** janë:

1. Programet e transparencës nuk janë të përditësuara dhe mungon një pjesë e dokumenteve të cilat duhet të jenë të publikuara, në kuptim të nenit 7, të ligjit “Për të drejtën e informimit”;
2. Gjuha e përdorur nuk është lehtësisht e kuptueshme për qytetarët dhe materialet në programin e transparencës nuk janë të linkuara;
3. Programi i transparencës nuk është ikonë parësore në faqen e internetit;
4. Konstatohet se koordinatorët e të drejtës për informim, janë në nivel specialisti dhe kanë akses të limituar në strukturat e tjera të ministrisë. Kjo sjell vështirësi në vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar brenda afatit 10 ditor. Gjithashtu, janë konstatuar shumë raste kur kërkesat për informacion nuk kalojnë te koordinatori, por delegohen në struktura të tjera të ministrisë.

Gjatë vitit 2017, koordinatorët e të drejtës për informim të ministrive kanë trajtuar gjithsej **417** kërkesa për informacion publik dhe vetëm **3** prej tyre janë refuzuar.

Autoritetet publike duhet të përditësojnë programet e transparencës. Koordinatorët e të drejtës për informim nuk zotërojnë njohuritë e mjaftueshme për kuadrin ligjor çka sjell që implementimi i këtij ligji të mos jetë në nivelin e duhur. Gjuha në të cilën publikohen dokumentet duhet të jetë lehtësisht e lexueshme nga qytetarët.


Gjithashtu, zbatimi i standardeve më të mira ndërkombëtare kërkon që koordinatorët të jenë të trajnuar dhe të kualifikuar madje të jenë dhe të stimuluar financiarisht. Për sa më sipër, vijon puna për të ofruar trajnime për zbatimin sa më të saktë të ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe për të rritur ndërgjegjësimin e autoriteteve publike për t’iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve sipas parashikimeve ligjore.

## 2.2 Trajtimi i ankesave

Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” gjatë vitit 2017, pranë Zyrës së Komisionerit u depozituan **560 ankesa**, prej të cilave **395** janë zgjidhur me ndërmjetësim. Për **66** nga këto ankesa, Komisioneri është shprehur me “Vendim”. **77** ankesa kanë rezultuar jashtë objektit. **8** ankesa kanë qenë jashtë afatit dhe **14** ankesa kanë rezultuar të paplota.


Fakti që pjesa më e madhe e ankesave janë zgjidhur me ndërmjetësim tregon efektivitetin e ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit. Pjesa më e madhe e ankesave të shqyrtuara nga Zyra e Komisionerit kanë qenë ankesa të drejtuara nga qytetarët. Konkretisht **430** ankesa janë depozituar nga qytetarët ndërsa **130** ankesa janë depozituar nga OJF. Fakti që numri më i madh i ankesave vinë nga qytetarët është një tregues mjaft i mirë i impaktit të ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi të drejtën e informimit.

### 560 Ankesa në vitin 2017





### Ankesa në vite 2014-2017




Nga grafiku i mësipërm duket që ka një rënie të numrit të ankesave nga viti 2016 në vitin 2017. Ky është një tregues që lidhet me rritjen e përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike në dhënien e informacionit të kërkuar, për rrjedhojë ka një rënie të lehtë në numrin ankesave drejtuar Zyrës së Komisionerit. Një tregues që na përforcon idenë se jemi përballë një përmirësimi të situatës së transparencës nga ana e institucioneve publike, ka të bëjë edhe me numrin e vogël të refuzimit të kërkesave nga ana e autoriteteve publike siç raportohet në kapitullin 2.1

### 2.3 Hetime administrative


Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit, ka vazhduar punën për realizimin e përgjegjësisë kryesore, mbikëqyrjen dhe garantimin e të drejtës së qytetarëve për akses në informacion publik, duke u mbështetur në vendosjen e balancës dhe respektimin e parimit të proporcionalitetit.

Zyra e Komisionerit ka realizuar **98** hetime administrative në fushën e të drejtës për informim me synim verifikimin e ankesave të depozituara. Janë dërguar pranë Autoriteteve Publike **252 kërkesa** për parashtrime ndërsa **24 ankesa** vijojnë të jenë në proces. Gjithashtu, janë dhënë **66** vendime për Autoritetet Publike, prej të cilave **57** vendime urdhërimi, **3** vendime rrëzimi, si dhe **6** vendime me sanksion gjobë. Gjatë këtij viti janë realizuar **10** seanca dëgjimore.

Inspektive në vite 2014-2017



Për vitin 2017 Komisioneri u shpreh me **66 Vendime**



## 2.4 Strategji dhe indikatorë

### 2.4.1 Strategjia Ndërsektorale për Reformën në Administratën Publike

Zyra e Komisionerit, si një institucion i cili ka në fokus forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike, është pjesë e Strategjisë Ndërsektorale për Reformën në Administratën Publike 2015 – 2020 (SNRAP). Objektivi që duhet të përmbush Zyra e Komisionerit në këtë strategji është rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion. Ky objektivi synohet të arrihet

nëpërmjet aktiviteteve si vënia në zbatim e programit institucional të transparencës nga autoritetet publike, me qëllim garantimin e aksesit në informacion nga qytetarët dhe shoqëria civile. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij procesi.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë rregullisht në takimet e organizuara nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike me qëllim monitorimin e zbatimit të këtij objekti. Nga raportet e monitorimit vjetor për zbatimin e Planit të Veprimit të SNRAP, rezulton që aktivitetet për të cilat është përgjegjëse Zyra e Komisionerit janë përmbushur në përputhje me pasaportën e indikatorëve të kësaj strategjie.

Në bashkëpunim me përfaqësuesit e Departamentit të Administratës Publike si dhe me asistencën e ekspertëve të SIGMA/OECD, Zyra e Komisionerit ka hartuar masat që do të ketë në Planin e Veprimit të SNRAP për vitet 2018-2020.

#### 2.4.2 Kontrata Sektoriale e Mbështetjes Buxhetore për Reformën në Administratën Publike

Me VKM nr. 686, datë 29.9.2016, u miratua në parim marrëveshja e financimit, ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Evropian, programi i veprimit IPA 2015 për Shqipërinë.

Një ndër kontratat e firmosura është edhe “*Kontrata Sektoriale e Mbështetjes Buxhetore për Reformën në Administratën Publike*”, nëpërmjet së cilës qeveria shqiptare përfiton 28 milion euro mbështetje buxhetore që shkon për sektorin e Reformës së Administratës Publike. Disbursimi i këtyre fondeve shtrihet në katër vite dhe përfitimi i tyre bazohet në realizimin e plotë ose të pjesshëm të 10 (dhjetë) indikatorëve sipas objektivit të vendosur në këtë kontratë për çdo vit të zbatimit të saj.

Zyra e Komisionerit është përgjegjëse për zbatimin e një prej 10 indikatorëve të parashikuar në këtë kontratë e konkretisht: *Përmirësimi i zbatimit të ligjit për qasje në informacion* ku rezultati i pritshëm është: *Rritja e përgjegjshmërisë së administratës publike*.

Nga vlerësimi që ka kryer Komisioni Evropian për zbatimin e kësaj kontrate për vitin 2016, janë disbursuar fondet të cilët kanë kaluar në buxhetin e shtetit në përputhje me realizimin e

plotë ose të pjesshëm të indikatorëve. Ndër 5 (pesë) indikatorët e realizuar plotësisht, ka qenë dhe indikator për të cilën Zyra e Komisionerit është përgjegjëse për zbatimin e tij.

Për të vlerësuar nëse indikator është përmbushur ose jo, referuar metodologjisë së dakortësuar me Delegacionin e BE në Tiranë, Zyra e Komisionerit ka kërkuar nga 128 Autoritete Publike informacionin mbi regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve si dhe të vetë deklarojnë mbi përmbushjen e detyrimeve ligjore që dalin në përputhje me nenin 15 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”. 108 Autoritete Publike kanë kthyer përgjigje, duke u shprehur se për vitin 2017 janë trajtuar **12090 kërkesa për informacion** dhe vetëm **578 prej tyre janë refuzuar**. Pra vetëm 4.7% e kërkesave është refuzuar nga ana e Autoriteteve publike.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si institucioni përgjegjës për zbatimin e këtij indikator është i angazhuar për realizimin e tij për vitet në vijim në përputhje me kërkesat e parashikuara në kontratë.

### 2.4.3 Strategjia Ndërsektorale Antikorrupsion

Zyra e Komisionerit është gjithashtu pjesë e Strategjisë Ndërsektorale Antikorrupsion. Gjatë këtij viti, ka vazhduar puna lidhur me realizimin e masave të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë, të cilat janë realizuar thuajse plotësisht.

Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me një grup ekspertësh të Bashkimit Evropian ka hartuar dy indikatorët që do të ketë në këtë strategji. Këta indikatorë do të masin jo vetëm nivelin e transparencës së institucioneve, si një nga instrumentet kryesor në luftën kundër korrupsionit, por do të shërbejnë dhe si tregues të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit. Gjithashtu, janë hartuar edhe masat që Zyra e Komisionerit do të ketë në planin e ri të veprimit të strategjisë kundër korrupsionit. Masat e propozuara nuk do të jenë vetëm pjesë e qasjes parandaluese të strategjisë, por është propozuar dhe një masë e cila bën pjesë në qasjen ndëshkimore.

Gjatë vitit, Zyra e Komisionerit ka realizuar një sërë aktiviteteve të parashikuara në komponentin nr. 6 të projektit të binjakëzimit antikorrupsion. Në bashkëpunim me ekspertët gjermanë të këtij projekti, është hartuar një manual trajnimi për mësuesit dhe nxënësit e gjimnazeve lidhur me të drejtën e informimit. Janë hartuar dy manuale që kanë të bëjnë me kufizimet e nenit 17, të ligjit “Për të drejtën e informimit” si dhe është hartuar një material i cili analizon të gjitha Direktivat e BE lidhur me informacionin mjedisor, informacionin gjeohapsinor apo ripërdorimin e informacionit publik.

## 2.5 Bashkëpunime

### 2.5.1 Bashkëpunimi me Projektin Star 2 të UNDP

Në kuadër të Projektit Star 2 “Suport për Reformën Administrative dhe Territoriale”, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me përfaqësuesit e UNDP, kanë hartuar termat e referencës për hartimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe për forcimin e kapaciteteve të punonjësve të bashkive lidhur me zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Ky komponent i projektit pritet të fillojë zbatimin gjatë vitit 2018.

### 2.5.2 Bashkëpunimi me ASPA

Edhe këtë vit ka vijuar bashkëpunimi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. E drejta për informim ka qenë pjesë e programit të trajnimit të detyruar për nëpunësit civil në periudhë prove. Janë organizuar 18 kurse trajnuese në të cilat kanë marrë pjesë 555 nëpunës civil.

## 3. E DREJTA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

### 3.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Në kuadër të monitorimit dhe mbikëqyrjes së ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Zyra e Komisionerit gjatë këtij viti ka ndërmarrë hapa cilësorë dhe sasiorë në garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe realizimin në praktikë të detyrimeve të kontrolluesve publikë dhe privatë.

Në këtë kuadër janë zhvilluar hetime administrative pranë kontrolluesve publikë dhe privatë me fokus të veçantë fushat që kanë impakt më të madh në privatësi dhe që reflektojnë zhvillimet teknologjike në përpunimin e të dhënave personale. Hetimet administrative kanë synuar sensibilizimin e sektorëve specifikë mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe evidentimin e problematikave gjatë përpunimit të të dhënave personale në sektorë të ndryshëm, me qëllim përmirësimin e tyre në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Me prioritet është trajtuar inspektimi për “Projektin e identifikimit dhe popullimit të adresës për çdo shtetas”, gjatë të cilit u konstatuan disa mangësi në zbatimin e tij në terren. Zyra e Komisionerit vlerëson gatishmërinë e kontrolluesve për të bashkëpunuar dhe për të përmbushur detyrimet ligjore në këtë fushë.

Është e rëndësishme të theksojmë bashkëpunimin me Autoritetin Italian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (Garante) në kuadër të inspektimit të përbashkët të ushtruar pranë dy kontrolluesve që operojnë në sektorin call-center në territorin Shqiptar. Procedura e ndjekur përbën një risi për Zyrën e Komisionerit pasi gjatë këtij inspektimi, i cili u asistua edhe nga homologët italianë, u aplikuan teknika të reja sa i përket evidentimit të procedurave përpunuese gjatë marketingut telefonik me klientë shtetas italianë dhe shqiptarë. Problematikat e konstatuara lidhen me garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave (pëlqimin dhe informimin), marrjen e masave të sigurisë dhe konfidencialitetit për të dhënat personale që përpunoheshin nëpërmjet rrjetit të telekomunikacionit dhe garantimin e transferimit të të dhënave të klientëve gjatë transferimit. Ky bashkëpunim mund të konsiderohet edhe si një hap paraprak në konkretizimin e zbatimit të Rregullores së Bashkimit Evropian lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar, e cila hyn në fuqi në maj të vitit 2018.


### 3.2 Trajtimi i ankesave

Gjatë vitit 2017 pranë Zyrës së Komisionerit janë paraqitur **205** ankesa për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale prej të cilave 38 kanë rezultuar jashtë objektit ndërsa **167** të tjera janë trajtuar sipas ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Për zgjidhjen e drejtë dhe të plotë të ankesave janë zhvilluar inspektime administrative pranë kontrolluesve të ndryshëm dhe janë ndjekur të gjitha hapat procedurale administrative deri në përfundimin e çështjes objekt ankese.

Objekt i ankesave të trajtuara kryesisht lidhet me:

- Cënimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale (e drejta për akses, si një e drejtë e rëndësishme e subjektit të të dhënave, që lejon këtë të fundit, të marrë informacion nga kontrolluesi lidhur me përpunimin e të dhënave të tij);
- Mungesa e sigurisë së të dhënave personale (përpunimi i të dhënave në rrjet dhe siguria online);
- Përpunimi i të dhënave në mënyrë jo të drejtë dhe të ligjshme (përhapja në mediat dhe portalet online);
- Vendosjes së kamerave në ambiente publike dhe private;
- Marketingut të drejtpërdrejtë në lidhje me komunikimet e pa kërkuara, nëpërmjet telefonit ose postës elektronike;
- Tejkalimi i afatit të mbledhjes së të dhënave personale për një qëllim të caktuar.

## Ankesa në vite 2014-2017



Rritja e numrit të ankesave të paraqitura këtë vit krahasuar me vitet e mëparshme, si dhe kompleksiteti i rasteve dhe i hetimeve administrative të zhvilluara nga Zyra e Komisionerit janë tregues i ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe i njohjes së tyre me të drejtat që i garanton ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

### 3.3 Hetimet administrative


Gjatë këtij viti janë kryer **184** inspektime, prej të cilave **153** në terren dhe **31** inspektime online. Sektorët kryesorë të kontrolleve administrative janë:

- Shëndetësia;
- Sektori bankar;
- Telekomunikacion, (procesi i shkatërrimit të të dhënave personale);
- Marketingu i drejtpërdrejtë;
- Agjencitë turistike;
- Call-center;
- Arsimi i lartë universitar publik dhe privat;
- Institucione publike dhe private të kujdesit shoqëror;
- Shoqëri Private të Sigurisë Fizike;
- Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Janë zhvilluar **95** seanca dëgjimore, pasi kontrolluesit janë njoftuar paraprakisht dhe në respektim të të drejtës së subjekteve për t'u dëgjuar në zbatim të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".


Pas përfundimit të procedurës administrative, Zyra e Komisionerit është shprehur me aktet përkatëse.

## Hetime Administrative në vite 2014-2017



Nga **153** inspektime në terren kryesisht në qytetin e Tiranës, por edhe në rrethe, **52** prej tyre janë kryer në kontrollues publik dhe **101** inspektime pranë kontrolluesve privat. Nga vetë Zyra e Komisionerit janë iniciuar **130** inspektime, ndërsa në bazë të ankesave janë kryer **23** inspektime.

Inspektimet online janë realizuar kryesisht lidhur me faqet e internetit të agjencive turistike si dhe në sektorin bankar në lidhje me shërbimet online që ata ofrojnë.





### 3.4 Rekomandime dhe Urdhra

Komisioneri në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, është shprehur me **64** Rekomandime.

Zyra e Komisionerit është shprehur me **11** Urdhra për “Ndalimin e përpunimit dhe grumbullimit të mëtejshëm të të dhënave dhe shkatërrimin e menjëhershëm të tyre të grumbulluar në mënyrë të paligjshme”, dhënë kontrolluesve publik dhe privat.

Nëpërmjet rekomandimeve dhe urdhrave është synuar të ndërgjegjësohet çdo kontrollues i të dhënave për të kryer përpunime në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, pa cënuar privatësinë e individit.

Nisur nga eksperiencia pozitive e një viti më parë ku Rekomandimet Unifikuese të Komisionerit rezultuan të suksesshme në implementim, edhe këtë vit Komisioneri ka vijuar me dhënien e Rekomandimeve të kësaj natyre në këta sektorë:

#### - **Rekomandim në Sektorin e Turizmit**

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e këtij sektori, në kuadër të impaktit që ka në jetën e çdo qytetari dhe rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave të tyre personale dhe privatësisë së tyre, për shkak të rritjes së fluksit të lëvizjeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të qytetarëve shqiptar dhe të huaj (në cilësinë e subjekteve të të dhënave) dhe përpunimit elektronik dhe manual të një sasive të madhe të dhënash personale nga agjencitë turistike.

Zyra e Komisionerit ka evidentuar disa nga problematikat e hasura më shpesh në këtë fushë. Kryesisht, rekomandimi ka konsistuar në:

1. Marrjen e masave për të publikuar “Politikat e privatësisë” si elementi bazë në ushtrimin e të drejtës për informim të çdo subjekti dhe detyrimin e përditësimit të formularit të njoftimit;
2. Marrjen e masave lidhur me përcaktimin e një afati kohor të arsyeshëm për mbajtjen e të dhënave personale të klientëve që përpunohen manualisht dhe elektronikisht;
3. Në rastet e përdorimit të sistemeve CCTV, marrja e masave për vendosjen e tabelave informuese sipas standardit të miratuar nga Komisioneri nëpërmjet Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar;
4. Të tregohet kujdes lidhur me marrëdhëniet që Agjencitë Turistike krijojnë me të tretë (në cilësinë e përpunuesit) dhe që kanë si objektiv përpunimin e të dhënave personale (qoftë

edhe akses në të dhëna). Këto marrëdhënie të sanksionohen me marrëveshje të shkruar midis palëve, në të cilën të parashikohen detyrimet në kuadër të garantimit të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave.

#### - **Rekomandim në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.**

Pas hetimeve administrative të zhvilluara pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Zyra e Komisionerit ka dalë me Rekomandim për këto institucione në varësi të shkeljeve të konstatuara si dhe me një rekomandim për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve si organ epror në lidhje me shkeljet e konstatuara në I.E.V.P.


Problematikat kryesore të konstatuara në këto institucione janë kryesisht shkelje të cilat lidhen me sasinë e të dhënave të mbledhura sa i përket subjekteve punëmarrës, masa të papërshtatshme për të garantuar sigurinë, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave elektronike, pajisjeve kompjuterike, sistemeve operative, sistemeve video-vëzhguese (CCTV), mungesa e rregullores për trajtimin e të dhënave personale dhe deklaratës së konfidencialitetit.

### 3.5 Sanksione administrative

Zyra e Komisionerit pas ushtrimit të hetimeve administrative pranë kontrolluesve të ndryshëm publik dhe privat, ka vendosur sanksione me gjobë në rastet kur shkeljet kanë qenë serioze, të përsëritura, apo në rast mos përmbushjeje të rekomandimeve/urdhrave të Komisionerit.

Në mbyllje të procedurave hetimore, Zyra e Komisionerit ka dalë me **22** vendime të cilat korrespondojnë me **36** sanksione administrative.

Sanksione administrative në vitet 2014-2017



### 3.6 Njoftimi

Gjatë vitit 2017, në përmbushje të detyrimit ligjor kanë njoftuar për përpunimin e të dhënave personale **168** subjekte kontrolluese. Numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara në Regjistrin Qendror të Subjekteve Kontrolluese në total është **5364**.

|                                                                                   |                                            |                                                 |
|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|-------------------------------------------------|
|  | Regjistri Qëndror i Subjekteve Kontrollues | • <b>5364</b> Kontrollues të regjistruar        |
|                                                                                   | Vetëm për vitin 2017                       | • Kanë njoftuar <b>168</b> subjekte kontrollues |


### 3.7 Transferimi ndërkombëtar

Është ndjekur me përparësi monitorimi i procesit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale, kryesisht në sektorë strategjikë si banka dhe në fushën farmaceutike, në funksion të mbrojtjes më të mirë të të dhënave personale të qytetarëve.

Gjithashtu, me indicie nga plotësimi i Formularit të Njoftimit, në rastet ku është konstatuar se realizohet transferim në vende me nivel jo të mjaftueshëm, është kërkuar informacion shtesë nga kontrolluesit dhe më tej janë shqyrtuar praktikatat përkatëse të transferimeve.

Janë dhënë gjithsej **12 vendime mbi lejimin e transferimit ndërkombëtar**.

#### TRANSFERIM NDËRKOMBËTAR I TË DHËNAVE NË VITE 2014-2017



## 4. VEPRIMTARIA LIGJORE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian, një hap i rëndësishëm mbetet përjasja e plotë e legjislacionit në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale me atë të *Acquis Communautaire*.

Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 prill 2016 “*Mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC*” (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave ose GDPR) u miratua në datën 14 prill 2016 nga Parlamenti Evropian dhe do të hyjë në fuqi më 25 maj 2018.

Përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit kombëtar me këtë akt ligjor evropian, por edhe me Direktivën (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 prillit 2016 “*Mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga organet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit, ndjekjes së veprave penale ose ekzekutimit të dënimeve penale, si dhe me lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave*”, është ndër parashikimet e vendosura nga ana e Zyrës së Komisionerit në tabelat e planifikimit të akteve që përafrojnë *acquis* në përmbushje të Planit Kombëtar të Integritetit Evropian (PKIE). Në këtë drejtim Zyra e Komisionerit ka përkthyer dhe studiuar Rregulloren e BE-së (GDPR-ja) si dhe ka filluar punën për përgatitjen e paketës së amendimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Gjithashtu si rezultat i mendimeve të marra nga palët e interesuara dhe shoqëria civile, por edhe trajtimit të ankesave janë përgatitur amendimet lidhur edhe me ligjin “Për të drejtën për informim”. Zbatimi i ligjit deri më tani ka treguar se pjesa më e madhe e dispozitave kanë qenë efektive dhe se rregullat po funksionojnë mirë, por ka dispozita të cilat duhen përmirësuar.

### 4.1 Hartimi i akteve rregullatore

Për vitin 2017 në drejtim të zbatimit të detyrimeve që burojnë nga akte të tjera ligjore apo nënligjore është:

- Miratuar Udhëzimi nr. 46/2017 “*Për nivelin e sigurisë së subjekteve publike dhe private*” në zbatim të pikës 4 të nenit 12 të ligjit nr.19/2016 “Për Masat Shtesë të Sigurisë Publike”;


- Miratuar Udhëzimi i përbashkët, nr. 1181, datë 30.10.2017 “Për ngritjen dhe funksionimin e regjistrit elektronik të subjekteve që marrin masa shtesë të sigurisë publike”, i ministrit të Brendshëm dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Hartuar Projekt/ligji për “Krijimin e regjistrit të komunikimeve tregtare të pa kërkuara” dhe relacioni shpjegues. Ky projektligj parashikohet të jetë pjesë e paketës së ndryshimeve që do të sjell harmonizimi me Rregulloren e BE-së (GDPR);
- Hartuar Projekt/vendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” dhe relacioni shpjegues, pritët miratimi nga Këshilli i Ministrave.;
- Hartuar Projekt/Vendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të regjistrit elektronik të subjekteve kontrollues” dhe relacioni shpjegues, pritët miratimi nga Këshilli i Ministrave;
- Hartuar Projekt/Strategjia “Për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2018-2020” në të cilën janë parashikuar vizioni dhe objektivat institucionale për këto vite.

## 4.2 Dhënie mendimi për projekt/akte

Bazuar në germën a) të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, gjatë vitit 2017, Zyra e Komisionerit ka dhënë mendime ligjore për **2** projekt/ligje, **12** projekt/vendime, **4** projekt/marrëveshje ndërshtetërore, **1** Kod rregullator (për AMA) si dhe janë dhënë një sërë opinione ligjore si dhe kthim përgjigje të paraqitura nga kontrollues publik e privat. (Aneksi 2)

Gjithashtu, është dhënë asistencë për kontrollues të tjerë publikë dhe privatë lidhur me hartimin e rregulloreve të posaçme për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të garantimit të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale dhe deklaratave të pëlqimit të subjekteve të të dhënave; lidhur me përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV (në referim edhe të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri); rreth njoftimit dhe detyrimeve të tjera në kuadër të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale; përfshirjes së politikave të privatësisë në faqet e internetit; dhënie mendimi për transferimet ndërkombëtare; rreth publikimit në media të të dhënave personale; mbi fshirjet e të dhënave të publikuara në portale të ndryshme online, etj.

## Veprimtaria ligjore në vitet 2014-2017



### 4.3 Detyrime që burojnë nga akte të tjera ligjore

Akte ligjore në të cilat parashikohen edhe disa detyrime për Zyrën e Komisionerit në realizimin e tyre, janë:

#### **a. Ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”**

Në zbatim të nenit 16/3 dhe 24/3, të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, është miratuar Udhëzimi nr. 44/2016 “Për kushtet, kriteret e përpunimit dhe kohën e mbajtjes së të dhënave personale”. Mos zbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi është objekt i sanksioneve të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

#### **b. Ligji nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”**

Në zbatim të nenit 20/3 dhe 24/2, të ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” është miratuar Udhëzimi i përbashkët me Ministrin e Punëve të Brendshme nr. 515, datë 27.09.2016 “Për përpunimin e të dhënave personale nga rojet kufitare”. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerëson në mënyrë periodike, si dhe rast pas rasti,

përputhshmërinë e të dhënave të përpunuara sipas parashikimeve të pikave 3, 4 dhe 5 me qëllimin e përpunimit të tyre sipas këtij udhëzimi.

### **c. Ligji nr. 19/2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike”**

Në zbatim të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike”, referuar :

- Pikës 2, të nenit 5, është miratuar Udhëzimi i përbashkët, nr. 1181, datë 30.10.2017 “Për ngritjen dhe funksionimin e regjistrat elektronik të subjekteve që marrin masa shitesë të sigurisë publike”, i ministrit të Brendshëm dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Pikës 3 dhe 4, të nenit 12, nenit 14 dhe pikës 3 të nenit 20, është miratuar, Udhëzimi i Komisionerit nr. 46/2017 “Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë”. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i nivelit të sigurisë që duhet të garantojnë subjektet publike dhe private gjatë përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet mjeteve të përcaktuara në nenin 8 të ligjit nr.19/2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike”.

## **4.4 Monitorimi i Fletoreve Zyrtare**

Ka vijuar edhe në këtë periudhë kontrolli i fletoreve zyrtare për të evidentuar rastet e miratimit të projekt akteve ligjore dhe nënligjore për të cilat nuk është marrë mendimi i Zyrës së Komisionerit. Ky verifikim siç edhe kemi cituar në raportet e mëparshme bëhet me qëllim reflektimin e institucioneve në qasjen e legjislacionit që kërkojnë të miratojnë, me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga kontrolli i fletoreve zyrtare janë evidentuar **8** ligje dhe **3** VKM që kanë të bëjnë me të dhënat personale dhe që janë miratuar pa u dërguar për mendim pranë Zyrës së Komisionerit. (Aneksi 3)

## **4.5 Proceset gjyqësore**

Në lidhje me vendimet e Komisionerit dhe zbatimin e tyre, bazuar në numrin e vendimeve të lëna në fuqi nga gjykata ose ekzekutimin në mënyrë vullnetare të tyre edhe për këtë vit konstatohet një ecuri shumë pozitive.

Komisioneri për vitin 2017 në respektim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është shprehur me **66 vendime**, ndër të cilat janë ankimuar dhe janë **ndjekur 22 procese gjyqësore**, prej të cilave gjykata ka vendosur për **11** rrëzimin e padisë (lënien në fuqi të

vendimeve të Komisionerit), **4** pranim të padisë, **5** pushimin e procesit gjyqësor, **1** revokim padie, **1** pranim të pjesshëm padie.

#### *E DREJTA PËR INFORMIM*

| <i>Viti</i>                        | <b>2017</b> |
|------------------------------------|-------------|
| <b>Vendime</b>                     | <b>66</b>   |
| <b>Sanksione</b>                   | <b>6</b>    |
| <b>Procese Gjyqësore</b>           | <b>22</b>   |
| <b>Rrëzimin e padisë</b>           | <b>11</b>   |
| <b>Pranim të padisë</b>            | <b>4</b>    |
| <b>Pranim të pjesshëm padie</b>    | <b>1</b>    |
| <b>Pushim të procesit gjyqësor</b> | <b>5</b>    |
| <b>Revokim padie</b>               | <b>1</b>    |

Komisioneri për vitin 2017 në respektim të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, është shprehur **me 22 vendime**.

Nga këto 22 vendime, për **11 vendime**, subjektet përkatëse kanë ekzekutuar vullnetarisht sanksionet administrative. Për **9** vendime të pa ankimuara, Zyra e Komisionerit ka kërkuar ekzekutimin përmbartimor. Ndërsa për **3 vendime**, kontrolluesit përkatës kanë ngritur padi në gjykatë për të cilat është ndjekur procesi gjyqësor administrativ. Pas përfundimit të proceseve gjyqësore, gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të Komisionerit dhe është vijuar me kërkesën për ekzekutim të detyrueshëm nga Zyra e Përmbartimore.

#### *MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE*

| <i>Viti</i>                                 | <b>2017</b> |
|---------------------------------------------|-------------|
| <b>Vendime</b>                              | <b>22</b>   |
| <b>Sanksione administrative</b>             | <b>36</b>   |
| <b>Procese Gjyqësore</b>                    | <b>3</b>    |
| <b>Ekzekutime vullnetare</b>                | <b>11</b>   |
| <b>Kërkesë për ekzekutime përmbartimore</b> | <b>11</b>   |



Ndërsa për marrëdhëniet e punësimit, si pasojë e ristrukturimit të Zyrës së Komisionerit në vitin 2015, janë ankimuar **6** vendime, për të cilat janë ndjekur procedurat përkatëse në dy shkallët e gjyqimit administrativ. Për **5** çështje janë lënë në fuqi vendimet e Njesisë Përgjegjëse dhe për **1** çështje vijon procesi në Gjykatën Administrative të Apelit. Për asnjë rast nuk ka efekte financiare.

Vijon ndjekja e ekzekutimit të vendimeve të Komisionerit dhe njëkohësisht edhe ndjekja e proceseve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit, për çështje të ankimuara dhe mbartura nga vite të mëparshme.

## 4.6 Raportime

Në kuadër të përfshirjes së kontributit të Zyrës së Komisionerit dhe hartimit të raporteve janë përgatitur:

- Raporti për Ministrinë e Integritetit Evropian lidhur me Nënkomitetin IX në kuadër të Kapitullit 23 “Çështjet e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë”;
- Raporti për Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të Planit Kombëtar dhe Rekomandimeve të lëna nga Raporti i Shtetit për vitin 2016;
- Raporti për takimin e Grupit të Berlinit;
- Raporti në kuadër të “Takimit të IX të Nënkomitetit për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë BE-Shqipëri” zhvilluar në datën 28 prill 2017 në Bruksel;
- Raporti për hartimit të Planit të Veprimit për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, në Kapitullin 23 – Bashkëpunimi në Fushën e Gjyqësorit dhe të Drejtat Themelore, dhe është vijuar me takimet në Ministrinë e Drejtësisë, por njëkohësisht është raportuar periodikisht mbi punën e bërë për realizimin e objektivëve të përcaktuar në PKIE;
- Raporti për takimin e 7-të të Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike;
- Raporti i Ministrisë së Drejtësisë mbi Veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për periudhën 1 tetor - 30 nëntor 2017, për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2018;
- Raporti në kuadër të përgatitjes së takimit të parë të mekanizmit për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, raportuar pranë Kuvendit të Shqipërisë lidhur me nivelin e zbatimit të Rekomandimeve.

## 5. TRAJTIMI I ANKESAVE SIPAS LIGJIT NR. 146/2014 “PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK”

Në përmbushje të detyrës për shqyrtimin e ankesave në lidhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, për vitin 2017, Komisioneri është shprehur me **5 vendime**, prej të cilave:

1. Vendimi nr. 28, datë 13.02.2017, me palë ankuese Komitetin Shqiptar të Helsinkit, kundër Organit Publik/ Ministria e Drejtësisë. Objekti i ankimit: Ankim lidhur me cenimin e të drejtës për njoftim dhe konsultim publik për **projektligjin “Për dhënie amnistie”**, me anë të të cilit Komisioneri vendosi pranimin e ankesës dhe ti propozojë organit publik marrjen e masave administrative sipas nenit 10, të ligjit nr. 146/2014;
2. Vendimi nr. 54, datë 21.03.2017, me palë ankuese: Shoqata “Intelektualët e Rinj, Shpresë”, kundër Organit Publik/ Bashkia Shkodër. Objekti i ankimit: ankim lidhur me cenimin për njoftimin dhe konsultimin publik **për buxhetin e vitit 2017 dhe planin buxhetor afatmesëm 2018-2019 të Bashkisë Shkodër**, me anë të të cilit Komisioneri vendosi pranimin e ankesës kundër organit publik Bashkisë Shkodër dhe ti propozojë organit publik marrjen e masave administrative sipas nenit 10, të ligjit nr. 146/2014;
3. Vendimi nr. 80, datë 31.05.2017 me palë ankuese: Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim “EDEN”, kundër Organit Publik: Këshilli Kombëtar i Territorit. Objekti i Ankimit: Ankim lidhur me cënimin e të drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik, për **vendimin nr. 6, 08.04.2014 “Për Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e hidrocentralit “Dragobia”, Komuna Margegaj, Qarku Kukës**” me anë të të cilit Komisioneri vendosi rrëzimin e ankesës;
4. Vendimi nr. 81, datë 16.06.2017 me palë ankuese: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, kundër Organit Publik/ Ministrisë së Zhvillimit Urban. Objekti i ankimit: Ankim lidhur me cënimin e të drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik për projektligjin **“Për strehimin Social”**, me anë të të cilit Komisioneri vendosi pranimin e ankesës kundër organit publik dhe konstatimin e moszbatimit nga organi publik të procedurës të parashikuar në nenet 6, 7/1, 11 dhe 15/1, të ligjit nr.146/2014. Ky vendim u ankimua nga ministria përkatëse për të cilin gjykata vendosi kthimin e padisë pasi u konstatua me të meta;
5. Vendimi nr. 93, datë 11.10.2017 me palë ankuese Komiteti Shqiptar i Helsinkit, kundër organit publik/ Bashkia Tiranë. Objekti i ankimit: Ankim lidhur me cënimin e të drejtës për

njoftimin dhe konsultimin publik **për propozimin për rritjen e çmimit të ujit dhe miratimin e tij nga Këshilli Bashkiak Tiranë**, me anë të të cilit Komisioneri vendosi deklarin e mos kompetencës lidhur me ankesën e KSHH kundër Organit Publik Bashkia Tiranë, për shkak se projektakti objekt ankimi nuk është miratuar ende. Ky vendim është ankimuar në gjykatë dhe vijon ndjekja e këtij procesi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

## **6. NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Zyra e Komisionerit ka zhvilluar aktivitete të ndryshme me qëllim ndërgjegjësimin dhe promovimin e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

- **28 Janari, Dita Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, realizimi i aplikacionit “IDP Ankesa”**

Në kuadër të 28 Janarit – Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit zhvilloi konkursin “Privacy App”. Kjo iniciativë u mbështet nga Instituti “Harry Fultz”, nxënësit e të cilit realizuan një aplikacion për telefona të zgjuar (smartphones). Kjo risi mundëson realizimin e ankesës për çdo shkelje apo keqpërdorim të të dhënave personale drejtpërdrejtë nga telefoni. Aplikacioni “IDP ANKESA” është i disponueshëm për t’u shkarkuar nga të gjithë qytetarët në “play store” (për telefonat android) dhe në një fazë të dytë, do të mundësohet shkarkimi edhe për sistemin iOS.

- **Shkollat dhe trajnimet “Informim dhe Privatësi” - bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës dhe Akademinë e Sigurisë**

Zyra e Komisionerit në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar me Universitetin e Tiranës, bashkë organizuan në datat 23-27 janar Shkollën Dimërore “Informim dhe Privatësi”. Në edicionin e parë të kësaj Shkolle u përzgjedhën për të marrë pjesë 60 studentë dhe staf akademik e administrativ nga të gjithë fakultetet e Universitetit të Tiranës.

Kjo iniciativë u realizua edhe me Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës, kësaj radhe si “Shkolla Verore - Informim dhe Privatësi” në datat 30 maj – 2 qershor 2017. Shkolla Verore u mbështet nga Prezenca e OSBE në Shqipëri. Në të u përzgjedhën për të marrë pjesë mbi 100 studentë dhe staf akademik e administrativ të Universitetit të Vlorës.

Në të dy këto aktivitete, u trajtuan tema dhe raste konkrete nga praktika shqiptare dhe ajo evropiane, si në drejtim të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale, ashtu edhe për të drejtën e informimit.

Në datat 21-22 nëntor 2017, Zyra e Komisionerit zhvilloi në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, trajnimin “Informim dhe Privatësi”. Në këtë aktivitet u përzgjedhën për të marrë pjesë 41 persona, staf akademik dhe administrativ nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit. Trajnimi u fokusua në zgjerimin e njohurive për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe ligjit për të drejtën e informimit. Njëkohësisht, trajnimi u fokusua edhe tek ligji nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, dhe Udhëzimet nr. 3 dhe nr. 46 të Komisionerit, që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtës së qytetarëve për privatësi në raport me *“përpunimin e të dhënave me sisteme videosurvejimi”* dhe me *“nivelin e sigurisë së përpunimit të të dhënave nga masat shtesë të sigurisë”*.

- **“Konferenca III Kombëtare për të Drejtën e Informimit, Koordinatorin dhe Shoqëria Civile”, Konferencat rajonale për të drejtën e informimit, 28 Shtatori – Dita e të Drejtës për Informim**

Zyra e Komisionerit organizoi në bashkëpunim me Zyrën e Prezencës së OSBE në Shqipëri, *“Konferencën III Kombëtare për të Drejtën e Informimit, Koordinatorin dhe Shoqëria Civile”*. Në këtë Konferencë u prezantuan dy dokumente të rëndësishme për mirëfunksionimin e Autoriteteve Publike në respektimin e të drejtës për akses në dokumentet zyrtare: *“Udhëzuesi për Koordinatorin e të drejtës për informim”*, - manuali për nëpunësit e ngarkuar me administrimin e procesit të dhënies së informacionit i cili është hartuar me mbështetjen e SIGMA/OECD; *“Instrumenti i Vetëvlerësimit të Autoritetit Publik”* - përcakton hapat e përmbushjes së detyrimeve në raport me dispozitat e ligjit “Për të drejtën e informimit”, të çdo institucioni të administratës publike.

Zyra e Komisionerit gjatë vitit 2017 zhvilloi edhe 4 Konferenca Rajonale “E drejta për informim, autoritetet publike, koordinatori dhe programet e transparencës” në Durrës, Lezhë, Peshkopi dhe Sarandë. Në këto konferenca, u trajnuan përfaqësues të Prefekturës, të njësive të vetqeverisjes vendore, të organeve të drejtësisë dhe Policisë së Shtetit, të institucioneve qendrore në nivel vendor, etj., për detyrimet e ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe u prezantuan edhe funksionet e portalit *“pyetshtetin.al”* si një platformë e integruar informative për qytetarët.

Më 28 Shtator – Ditën e të Drejtës për Informim, Zyra e Komisionerit prezantoi një poster ndërgjegjësues, i cili simbolizon lulen e mirëqeverisjes. Nismës iu bashkuan shumë Autoritete publike qendrore, vendore dhe nga sistemi i drejtësisë.

- **Marrëveshje bashkëpunimi**

Gjatë këtij viti Zyra e Komisionerit nënshkroi dy marrëveshje bashkëpunimi:

- Marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit. Dokumenti parashikon ndër të tjera dhënien e opinioneve për hartimin e akteve të ndryshme ligjore e nënligjore, shkëmbimin e informacioneve në funksion të veprimtarisë respektive të institucioneve, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, apo përgatitjen dhe shkëmbimin e botimeve;
  - Marrëveshje bashkëpunimi me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve. Ky dokument i angazhon palët në zbatimin e standardeve më të larta në mbrojtje të privatësisë dhe të dhënave personale të qytetarëve dhe njëkohësisht, në respektimin e të drejtës për informimin me dokumentet zyrtare.
- **Studimi “Privatësia dhe siguria e të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga grup mosha 15-18 vjeç” dhe fushata ndërgjegjëse “Privatësi dhe Siguri”**

Zyra e Komisionerit në aktivitetin e organizuar për “Ditën e Internetit të Sigurt”, në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, prezantoi Studimin “Privatësia dhe siguria e të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga grup mosha 15-18 vjeç” dhe Rezolutën për “Kuadrin ndërkombëtar të aftësimin për privatësinë” aprovuar në Konferencën e 38-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (fushata ndërgjegjëse “Privatësi dhe Siguri”).

Kjo fushatë nisi me takimin e realizuar në mjediset e Zyrës së Komisionerit me përfaqësues të DAR/ZA nga i gjithë vendi. Gjatë vitit, janë zhvilluar takime në qarqet e Dibrës, Kukësit, Shkodrës, Lezhës, Elbasanit, Korçës, Durrësit, Gjirokastrës dhe rrethin e Sarandës me mësues të lëndëve të edukatës shoqërore, TIK dhe psikologë për konsultimin e gjerë të këtij dokumenti. Zyra e Komisionerit po bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë që “Kuadri i aftësimin të mësuesve” të përfshihet në kurrikulën e arsimit 9-vjeçar.

#### **- Organizimi i trajnimeve për mbrojtjen e të dhënave personale**

Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri organizuan në 15 qershor 2017, trajnimin me temë *“Videosurvejimi dhe mbrojtja e të dhënave personale”*. Aktiviteti kishte për qëllim prezantimin e rregullave dhe parimeve të mbrojtjes së privatësisë në raport me procesin e videosurvejimit. Pjesëmarrës në trajnim ishin përfaqësues të institucioneve qendrore, gjykatave, prokurorisë, policisë, organeve të vetqeverisjes vendore, sistemit të arsimit dhe shëndetësisë, agjencive të ndryshme të shërbimeve publike, sistemit bankar, kompanive të telekomunikacionit, sigurimeve, call center, shoqërive të ruajtjes dhe sigurisë fizike, të shoqatave të ndryshme të biznesit, etj.

Në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës u zhvillua në datat 27-28 shkurt 2017, seminari i 3-të trajnues me temë *“Mbrojtja e të dhënave personale, me fokus të veçantë, mbrojtja e të dhënave sensitive që publikohen në vendimet gjyqësore”*. Në këtë seminar morën pjesë gjyqtarë nga gjykatat e të gjitha niveleve.

#### **- Aktivitete të organizuara në bashkëpunim me fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (SOROS)**

Zyra e Komisionerit me Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” zbatuan projektin “Matja e kapaciteteve të koordinatorëve të të drejtës për informim dhe koordinatorëve të njoftimit dhe konsultimit publik”. Në këtë kuadër u zhvilluan 3 tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të drejtorive juridike dhe koordinatorë të autoriteteve të pavarura, ministrive dhe institucioneve të varësisë si dhe organeve të vetqeverisjes vendore me synim matjen e kapaciteteve dhe forcimin e rolit të koordinatorëve. Gjatë vitit 2018 pritet të hartohet një raport me propozimet përkatëse.

#### **- Faqja e internetit të Zyrës së Komisionerit dhe Revista “Informim Dhe Privatësi”**

Zyra e Komisionerit realizoi faqen e saj të re zyrtare në internet ku çdo qytetar mund të konsultojë lehtësisht legjislacionin mbi të cilin funksionon Autoriteti dhe vendimmarrjen e tij. Lajme dhe njoftime mbi aktivitetin e përditshëm të Zyrës së Komisionerit përcillen në kohë reale, duke krijuar një hapësirë të plotë dhe interaktive informative për qytetarët dhe modelin e transparencës për Autoritetet Publike.

Gjatë vitit 2017 Zyra e Komisionerit publikoi numri 3 dhe 4 të Revistës “Informim Dhe Privatësi”. Në këto botime janë pasqyruar aktivitetet kryesore, të organizuara nga Zyra e Komisionerit.

## 7. VEPRIMTARIA NDËRKOMBËTARE

- **Zyra e Komisionerit, organizatore e Konferencës së Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave (CEDPA) në 3-4 Maj 2018 si dhe e Konferencës Botërore (ICDPPC) në vitin 2019**

Zyra e Komisionerit, në cilësinë e anëtares me të drejta të plota të Konferencës së Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave (CEDPA), aplikoi zyrtarisht pranë Sekretariatit, me qëllim organizimin e edicionit të 28-të të saj në vitin 2018, propozim i cili u miratua duke e anëtarësuar automatikisht Zyrën e Komisionerit në Komitetin e Akreditimit dhe Mbështetjes të Konferencës, së bashku me Hungarinë dhe Qipron.

Pas aplikimit zyrtar të depozituar në mars 2017, me qëllim organizimin e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë në vitin 2019 (ICDPPC), Komiteti Ekzekutiv i rekomandoi anëtarësisë kandidaturën e përzgjedhur të Zyrës së Komisionerit, e cila u miratua pa vërejtje dhe u njoftua zyrtarisht në datën 20 korrik 2017. Ashtu sikurse për Konferencën Evropiane edhe kjo konferencë do të zhvillohet për herë të parë në Shqipëri.

Gjithashtu në Konferencën e 39-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) të 2017-ës u zhvilluan zgjedhjet për kreun dhe anëtarët e rinj të Komitetit Ekzekutiv. Komisioneri Shqiptar për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zgjodh anëtar-vëzhgues në këtë forum. Prej tetorit 2018, ai do të jetë anëtar me të drejta të plota në organin drejtues të organizatës.

- **Zyra e Komisionerit bashkëpunon me Instrumentin e Asistencës Teknike për Shkëmbimin e Informacionit të Bashkimit Evropian (TAIEX)**

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Instrumentin e Asistencës Teknike për Shkëmbimin e Informacionit të Bashkimit Evropian (TAIEX), organizuan në datat 14-15 nëntor 2017 trajnimin me temë "Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, ndikimi në vendet candidate për anëtarësim në BE". Misioni u fokusua në risitë që sjell Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së si dhe Direktiva e re e BE-së nr. 680/2016 në raport me legjislacionin evropian në fuqi dhe në marrëdhëniet me palë të treta.

- **Bashkëpunimi me T-PD, WP29 dhe Grupi i Berlinit**

Në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, Zyra e Komisionerit mori pjesë në takimet e Grupit të Punës së Nenit 29 (WP29) dhe në T-PD (Komitetin Konsultativ të Konventës nr. 108 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale"). Në këto takime është diskutuar kryesisht për opinione që pritet të miratohen në fushën e policisë dhe atë të shëndetësisë, etj. Është marrë pjesë edhe në konferencën e dytë të mbikëqyrjes së inteligjencës 2017 (*International Intelligence Oversight Forum 2017*) me temë "Dilemat dhe praktikat më të mira në mbikëqyrjen e inteligjencës". Gjithashtu, në nëntor 2017 është marrë pjesë në Takimin e 62-të të Grupit Ndërkombëtar të Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupi i Berlinit).

- **Bashkëpunimi me Këshillin e Evropës**

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Këshillin e Evropës organizuan në 5 dhjetor 2017 seminarin me temë "Mbrojtja e privatësisë në media" me ekspertë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

- **Pjesëmarrje në Konferencën Evropiane dhe Botërore të Komisionerëve të të drejtës për informim**

Përfaqësues të Zyrës së Komisionerit kanë marrë pjesë në Konferencën Evropiane dhe Botërore të Komisionerëve të të drejtës për informim. Përfaqësuesit e Zyrës mbajtën në të dy konferencat nga një prezantim lidhur me zhvillimin e të drejtës për informim në Shqipëri si dhe diskutuan mbi rastet dhe praktikën e krijuar.

- **Pjesëmarrje në Konferencën ndërkombëtare "Mbrojtja e të dhënave dhe e drejta e informimit – në kontradiktë apo në mbështetje të njëra-tjetrës?"**

Përfaqësues të Zyrës së Komisionerit mbajtën një prezantim në Konferencën ndërkombëtare "Mbrojtja e të dhënave dhe e drejta e informimit – në kontradiktë apo në mbështetje të njëra-tjetrës?", organizuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Shtetit të Brandenburgut në Gjermani.

- **Bashkëpunimi me Shoqatën e Frankofonisë**

Në kuadër të 10 vjetorit të themelimit të Shoqatës Frankofone të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (AFAPDP) anëtare e së cilës është edhe Zyra e Komisionerit, u përgatit në frëngjisht një artikull me disa nga arritjet më të rëndësishme të KDIMDP-së gjatë periudhës



së anëtarësimit në këtë organizëm, i cili u përfshi në një botim që u publikua dhe prezantua gjatë aktiviteteve të organizuara për këtë përvjetor.

#### - **Manuali i së Drejtës Evropiane në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave**

Në vijim të publikimeve të Zyrës së Komisionerit, u përgatit për botim në gjuhën shqipe “Manuali i së Drejtës Evropiane në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave”. Ky botim i hartuar bashkërisht nga Agjencia e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (ADTH), Këshilli i Evropës dhe Zyra e Kancelarit të Gjykatës Evropiane të së Drejtave të Njeriut, është deri më tani përmbledhja më e plotë e jurisprudencës së Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, origjinali anglisht dhe frëngjisht i së cilës është përkthyer në 23 gjuhë të ndryshme.

## **8. MENAXHIMI BUXHETOR**

#### - **Ndjekja dhe zbatimi i praktikave mbi menaxhimin e burimeve njerëzore**

Zbatimi dhe respektimi i legjislacionit të shërbimit civil ka qenë një nga aspektet kryesore të menaxhimit në tërësi. Edhe pse kërkesat për shtim të kapaciteteve janë bërë prezentë vit pas viti, gjatë hartimit të kërkesave buxhetore PBA, struktura organizative e Zyrës së Komisionerit, për vitin 2017 mbeti e njëjtë në numër, 35 punonjës. Zyrës së Komisionerit, ju mundësua rekrutimi i 6 (gjashtë) punonjësve me kontratë të përkohshme pune.

Është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit. Në zbatim të Planit Vjetor të Trajnimeve, punonjësit u përfshinë në një proces trajnimesh, brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësuan shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikën më të mirë.

#### - **Fondi buxhetor dhe realizimi**

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planifikuar për vitin 2017, me ndryshimet e kryera gjatë vitit, Zyra e Komisionerit ka shpenzuar **vlerën buxhetore 63.618 (në mijë lekë)**. Është realizuar buxheti në tërësi në masën 97%, kundrejt planit vjetor, të ndryshuar.

Gjatë paraqitjes së kërkesave buxhetore në PBA-në 2017-2019 është kërkuar rritje e tij. Buxheti i akorduar nuk ka qenë i mjaftueshëm për mbulimin e disa projekteve të Zyrës së Komisionerit.

Në zbatim të planit për shpenzime dhe investime, Zyra e Komisionerit ka hartuar e zbatuar edhe planin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2017, përmbante 2 procedura prokurimi me tenderim, ndërsa mbulimi i nevojave të tjera është realizuar nëpërmjet prokurimeve me vlera të vogla.

Zyra e Komisionerit ka ngritur sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Mbi menaxhimin financiar e kontrollin", i ndryshuar si dhe në parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitetet, transparencë, ekonomi dhe eficensë.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet në %, çdo kategori shpenzimesh, përkundëjt totalit të buxhetit, si dhe realizimi në % dhe vlerë, i secilës kategori shpenzimesh, përkundëjt buxhetit të akorduar.

**TABELA E AKORDIMIT TË BUXHETIT DHE REALIZIMIT**

**VITI 2017**

**000 / lekë**

| <b>Nr.</b> | <b>EMËRTIMI</b>                  | <b>PLAN</b>   | <b>% kundrejt totalit</b> | <b>Fakt 12 mujor</b> | <b>% realizimi kundrejt planit vjetor</b> |
|------------|----------------------------------|---------------|---------------------------|----------------------|-------------------------------------------|
| 1          | Paga                             | 36700         | 55.9 %                    | 35.917               | 97.8%                                     |
| 2          | Sigurime shoqërore               | 6400          | 9.7 %                     | 5.742                | 89.7%                                     |
| 3          | Mallra e shërbime të tjera       | 19660         | 29.9%                     | 19.206               | 97.6%                                     |
| 4          | Investime                        | 2500          | 3.8. %                    | 2.380                | 95%                                       |
| 5          | Transferta te buxhetet familjare | 290           | 0.4%                      | 290                  | 100%                                      |
| 6          | <b>Kuotizacion</b>               | 100           | 0.1%                      | 83                   | 83%                                       |
|            | <b>Totali</b>                    | <b>65.650</b> | <b>100%</b>               | <b>63.618</b>        | <b>96.9%</b>                              |

Në strukturën e Zyrës së Komisionerit nuk ka njësi të auditit të brendshëm. Për vitin 2017 nuk jemi përfshirë në planin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

#### **Të ardhurat nga sanksionet/gjoha**

|                                                                |                     |
|----------------------------------------------------------------|---------------------|
| Totali i Sanksioneve<br>në Vitin 2017                          | 1820 (në mijë lekë) |
| Për shkelje të dispozitave të<br>ligjit 9887/2008, i ndryshuar | 1120 (në mijë lekë) |
| Për shkelje të dispozitave të<br>ligjit 119/2014               | 700 (në mijë lekë)  |

Të arkëtuara  
1000 (në mijë lekë)

Të pa arkëtuara  
820 (në mijë lekë)

- Për vitin 2017, sanksionet e vendosura janë në shumën 1820 (në mijë lekë);
- Për sanksionet e vendosura në vitin 2017, vlera e arkëtuar në shumën 1000 (në mijë lekë);
- Në vitin 2017 është arkëtuar edhe shuma 1590 (në mijë lekë), gjoha të vendosura në vitin 2016, por të mbartura në vitin 2017;
- Shuma totale e arkëtuar në vitin 2017 është 2590 (në mijë lekë).

| Viti   | Shuma e gjobave në vite 2015-2017 |                     |
|--------|-----------------------------------|---------------------|
|        | Të arkëtuara                      | Të pa arkëtuara     |
| 2015   | 4580 (në mijë lekë)               | 2070 (në mijë lekë) |
| 2016   | 3148 (në mijë lekë)               | 1052 (në mijë lekë) |
| 2017   | 2590 (në mijë lekë)               | 820 (në mijë lekë)  |
| Totali | 10318 (në mijë lekë)              | 3942 (në mijë lekë) |

## 9. PROBLEMATIKAT PËR VITIN 2017

Analiza e vitit të kaluar nga monitorimi apo mbikëqyrja e realizuar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, në zbatimin e ligjit mbi të drejtën e informimit dhe njoftimit e konsultimit publik si dhe krahasimi i treguesve në shifra, janë elementë thelbësorë për përcaktimin e problematikave të shfaqura gjatë kësaj periudhe raportimi.

Për përmbushjen e detyrimeve të autoriteteve publike që burojnë nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka ende nevojë për t’u përmirësuar:

- Trajtimi i ankesave në afat për shkak të mungesës së kapaciteteve të burimeve njerëzore në strukturën që merret me të drejtën e informimit;
- Shumica e autoriteteve publike nuk kanë programe të plota dhe të përditësuara transparence;
- Koordinatorët nuk zotërojnë njohuritë e nevojshme për kuadrin ligjor dhe rregullator të administratës publike çka sjell që zbatimin e këtij ligji të mos jetë në nivelin e duhur;
- Konstatohet se koordinatorët e të drejtës për informim të institucioneve të pushtetit qendror, janë në nivel specialisti dhe për rrjedhim kanë akses të limituar në strukturat e tjera;
- Kërkohej që koordinatorët të jenë të trajnuar, të kualifikuar dhe të stimuluar financiarisht;
- Rishikimi i ligjit është i nevojshëm;

Për sa i përket fushës së mbrojtjes së të dhënave personale, nga ankesat e paraqitura, hetimet administrative të ushtruara dhe gjithë procesi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së ligjit 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, janë konstatuar problematika lidhur me:

- Garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale me fokus të veçantë e drejta e aksesit në të dhënat personale;
- Kontrolluesit publikë kanë vështirësi në dallimin midis të drejtës për akses dhe të drejtës për informim gjatë trajtimit të ankesave të qytetarëve;
- Garantimin e detyrimit për informim nga kontrolluesi lidhur me mënyrën e përpunimit;
- Garantimin e detyrimit për korrigjim dhe fshirje të të dhënave nga kontrolluesi;
- Shërbimet online dhe përpunimin e të dhënave personale në rrjet nuk respektojnë gjithmonë rregullat e përpunimit të ligjshëm të të dhënave;
- Garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit nga kontrolluesit.

Ndërsa lidhur me zbatimin e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, vazhdon të jetë e ulët ndjeshmëria dhe angazhimi qytetar shprehur nga numri i pakët i ankesave duke pasur parasysh numrin e akteve ligjore dhe nënligjore që miratohen çdo vit. Komisioneri vlerëson rëndësinë e promovimit të transparencës dhe zbatimit të kuadrit ligjor duke zbatuar të gjitha hapat që ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” parashikon.

## 10. PRIORITETET PËR VITIN 2018

### Prioritetet për vitin 2018 mbeten:

|                                                                                                                                                                                                  |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| ▪ Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Institucionale 2018-2020;                                                                                                                                   |
| ▪ Përmirësim i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;                                                                                                                                |
| ▪ Hartimi dhe miratimi i programit model të transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore;                                                                                                  |
| ▪ Krijimi i regjistrit kombëtar të kërkesave dhe përgjigjeve të autoriteteve publike, portali <i>pyetshtetin.al</i> ;                                                                            |
| ▪ Përafrimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e BE 679/2016 dhe Direktivën 680/2016;                                                                          |
| ▪ Vazhdimi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” mbi plan tematik duke synuar unifikimin e praktikave në sektorë të ndryshëm; |
| ▪ Trajtimi i praktikave për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale sipas GDPR;                                                                                                        |
| ▪ Verifikim i zbatimit të Rekomandimeve/ Urdhrave të dhëna nga Zyra e Komisionerit;                                                                                                              |
| ▪ Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve dhe rritja e aktiviteteve ndërgjegjëse me qytetarët, autoritetet publike apo kontrolluesit publikë e privatë;                                      |
| ▪ Organizimi i Konferencës Evropiane, 3-4 Maj 2018.                                                                                                                                              |

## ANEKSI 1

Në funksion të zbatimit të Vendimit nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, sa më poshtë renditen kërkesat e shtjelluara si pjesë e Aneksit 1 të Raportit Vjetor 2017 të Zyrës së Komisionerit.

### **A- Zbatimi i rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të vitit paraardhës për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit.**

#### **1. Thellimin e monitorimit dhe mbikëqyrjes së ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.**

Për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar inspektime pranë institucioneve të pushtetit qendror, vendor si dhe institucioneve të pavarura, qoftë mbi bazë ankese apo dhe me iniciativën e saj. Autoritetet Publike janë monitoruar edhe për të verifikuar përditësimin e programeve të transparencës dhe regjistrave të kërkesave dhe përgjigjeve. Në përfundim të çdo monitorimi, Zyra e Komisionerit ka dalë me aktin përkatës ose ka vënë në dispozicion të Autoriteteve Publike gjetjet e saj me synim përmirësimin e nivelit të transparencës.

Zyra e Komisionerit gjatë këtij viti ka ndërmarrë hapa konkretë në kuadër të garantimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe realizimit në praktikë të detyrimeve të kontrolluesve publikë dhe privatë. Monitorimi është kryer nëpërmjet mekanizmave të brendshëm, kryesisht, ashtu edhe nëpërmjet indikatorëve të jashtëm, nga qytetarët dhe media. Tematika e monitorimit dhe mbikëqyrjes së ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ka qenë më specifike, sektorët janë përzgjedhur mbi madhësinë e kontrolluesve, por edhe duke u mbështetur në problematikat e aktualitetit.

#### **2. Rritjen e numrit të kontrolleve dhe hetimeve administrative, lidhur me respektimin e të drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me fokus të veçantë inspektimet kryesisht me plan tematik dhe në sektorë të ndryshëm.**

Inspektimet administrative të kryera për të drejtën e informimit, kanë konsistuar në verifikimin e ankesave të depozituara pranë Zyrës së Komisionerit si dhe inspektime të kryera për programet e transparencës. Ankesat e depozituara nga persona fizikë dhe persona juridikë kanë qenë kryesisht për mosrespektim të të drejtës për informim brenda afatit ligjor. Gjatë vitit 2017 janë kryer 98 hetime administrative, 3 më shumë se në vitin 2016.

Lidhur me inspektimet administrative të kryera për mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë këtij viti Zyra e Komisionerit ka intensifikuar kontrollat dhe hetimet administrative me initiative pranë kontrolluesve privatë dhe publikë, duke u fokusuar në sektorë të cilët përpunojnë sasi të mëdha të dhënash personale dhe që kanë një impakt të madh në jetën e individëve. Konkretisht, sektorët kryesorë të kontrolleve administrative janë shëndetësia, sektori bankar, telekomunikacioni, marketingu i drejtpërdrejtë, agjensitë turistike, call-center, Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, arsimi i lartë universitar privat dhe publik, institucione publike dhe private të kujdesit shoqëror si dhe shoqëri private të sigurisë fizike.

Në këtë kuadër, referuar shifrave, konstatohet që gjatë këtij viti janë ushtruar 184 inspektime (nga 179 në vitin 2016). Kjo rritje i dedikohet edhe numrit në rritje të ankesave të ardhura nga qytetarët, çka tregon një ndërgjegjësim më të madh mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale.

### **3. Rritjen e masave administrative për shkelje ligjore të konstatuara, me fokus të veçantë mungesën e programeve të transparencës dhe regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve.**

Në lidhje me masat administrative në sferën e së drejtës për informim, vlen të theksohet se Komisioneri për këtë vit është shprehur me **66** vendime për Autoritetet Publike, prej të cilave **57** vendime urdhërimi, **3** vendime rrëzimi, si dhe **6** vendime me sanksion gjobë, (ndërkohë që për vitin 2016 janë dhënë 36 vendime prej të cilave 3 vendime me sanksion gjobë).

### **4. Ndjekjen e zbatimit të Strategjive Ndërsektoriale në kuadër të të drejtës për informim, lidhur me indikatorët e matshëm.**

- Zyra e Komisionerit, si një institucion i cili ka në fokus forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike, është pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015 – 2020 (SNRAP). Nga raportet e monitorimit vjetorë për zbatimin e Planit të Veprimit të SNRAP, rezultojnë që aktivitetet për të cilat është përgjegjëse Zyra e Komisionerit janë përmbushur në përputhje me pasaportën e indikatorëve të kësaj strategjie. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e Departamentit të Administratës Publike si dhe me asistencën e ekspertëve të SIGMA/OECD, Zyra e Komisionerit ka hartuar masat që do të ketë në Planin e Veprimit të SNRAP për vitet 2018-2020;
- Zyra e Komisionerit është përgjegjëse për zbatimin e një prej 10 indikatorëve të parashikuar në *“Kontrata Sektoriale e Mbështetjes Buxhetore për Reformën në Administratën Publike”*. Ndër 5 (pesë) indikatorët e realizuar plotësisht, ka qenë dhe indikatorin për të cilin Zyra e Komisionerit është përgjegjëse për zbatimin e saj;
- Zyra e Komisionerit është gjithashtu pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale në luftën Kundër Korrupsionit. Gjatë këtij viti, ka vijuar puna lidhur me realizimin e masave të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë, të cilat janë realizuar thuajse plotësisht. Në bashkëpunim me një grup ekspertësh të Bashkimit Europian, janë hartuar dy indikatorët që Zyra e Komisionerit do të ketë lidhur me strategjinë. Këta indikatorë do të masin jo vetëm nivelin e transparencës së institucioneve, si një nga instrumentet kryesor në luftën kundër korrupsionit, por do të shërbejnë dhe si tregues të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit.

### **5. Dhënien e ekspertizës në vazhdimësi për përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e të dhënave personale, në përputhje me Rregulloren e re të Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të BE(GDPR).**

Përshtatja e legjislacionit vendas me GDPR, e cila hyn në fuqi në muajin maj të këtij viti, është objektivi kryesor i punës së Zyrës së Komisionerit për dy vitet në vijim në fushën e veprimtarisë për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo është parashikuar edhe në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE).

Që prej miratimit të saj, Zyra e Komisionerit është angazhuar nëpërmjet aplikimit për 1 projekt-konsorcium Horizont 2020 dhe 6 trajnime.

## **6. Verifikimin e vazhdueshëm të zbatimit të Rekomandimeve dhënë kontrolluesve.**

Verifikimi i rekomandimeve dhënë kontrolluesve mbetet një angazhim i vazhdueshëm i Zyrës së Komisionerit. Për këtë periudhë raportimi Zyra e Komisionerit, është fokusuar në shërbimet online dhe verifikimin e “Politikave të Privatësisë” në faqet zyrtare të kontrolluesve publikë dhe privatë.

Është verifikuar përmbushja e rekomandimeve të pushtetit vendor për 61 njësi të vetëqeverisjes vendore të dhëna gjatë vitit 2016 (proces në vazhdim).

Gjithashtu, verifikimi i rekomandimeve është realizuar edhe nëpërmjet përzgjedhjes së kontrolluesve në sektorët e hetuar kryesisht, si në fushën e arsimit dhe call center apo edhe nëpërmjet detyrimit që kanë vetë kontrolluesit për njoftimin për përmbushjen e rekomandimeve.

## **7. Rritjen e fushatave ndërgjegjëse në të dy fushat e veprimtarisë me institucione publike e private dhe shoqërinë civile.**

Zyra e Komisionerit ka vazhduar edhe për këtë vit trajnimin e target grupeve të ndryshme me parimet e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Konkretisht, janë zhvilluar disa trajnime për studentët dhe stafin akademik në Universitetin e Tiranës, Universitetin Ismail Qemali në Vlorë si dhe Akademinë e Policisë.

Janë trajnuar koordinatorët e të drejtës për informim në disa qytete të vendit si dhe është organizuar Konferenca III Kombëtare për të Drejtën e Informimit, ku u prezantuan për herë të parë 2 dokumente të rëndësishme si, Instrumenti i Vetëvlerësimit të autoriteteve publike mbi zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe Udhëzuesi për Koordinatorët.

Gjithashtu, janë zhvilluar disa trajnime të fokusuara tek përpunimi i të dhënave personale nëpërmjet videosurvejimit në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri apo përpunimi i të dhënave personale në media, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës.

Me rastin e 28 Janarit, Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale u promovua dhe realizimi i aplikacionit “IDP Ankesa” ku të gjithë qytetarët mund të ankohen pranë Zyrës së Komisionerit në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt.

## **8. Vazhdimin e edukimit të nxënësve dhe mësuesve për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale në ambientet digjitale.**

Zyra e Komisionerit në aktivitetin e organizuar për “Ditën e Internetit të Sigurt”, lançon fushatën “Privatësi dhe Siguri”. Në këtë aktivitet u prezantuan Rezoluta për “Kuatrin ndërkombëtar të aftësisë për privatësinë” aprovuar në Konferencën e 38-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë. “Kuatrin i aftësisë” është një dokument me 9 parime për mësuesit e arsimit të detyrueshëm për të edukuar me përgjegjshmëri nxënësit për mbrojtjen e privatësisë në epokën digjitale.

Fushata “Privatësi dhe Siguri” nisi me takimin e realizuar në mjediset e Zyrës së Komisionerit me përfaqësues të DAR/ZA nga i gjithë vendi. Për konsultimin e gjerë të këtij dokumenti janë zhvilluar takime në qarqet e Dibrës, Kukësit, Shkodrës, Lezhës, Elbasanit, Korçës, Durrësit, Gjirokastrës dhe rrethit të Sarandës me mësues të lëndëve të edukatës shoqërore, TIK dhe psikologë. Zyra e Komisionerit po bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë që “Kuatrin i aftësisë të mësuesve” të përfshihen në kurrikulën e arsimit 9-vjeçar.



## **9. Vazhdimin e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë dhe shfrytëzimin e instrumenteve të ndryshëm për forcimin e kapaciteteve institucionale.**

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Zyra e Komisionerit do të vijojë të kontribuojë nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës dhe praktikave më të mira, ashtu si dhe në nivel të koordinimit të iniciativave të përbashkëta. Autoriteti do të vijojë të luajë rol aktiv në forumet më të rëndësishme evropiane dhe ndërkombëtare në të cilat merr pjesë, si vijon:

- a. Në cilësinë e Anëtarit vëzhgues të Grupit të Punës së Nenit 29 (që nga 25 maj 2018, Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave);
- b. Në cilësinë e Anëtarit të Komitetit Konsultativ të Konventës 108 (T-PD) dhe Komitetit *ad hoc* për Mbrojtjen e të Dhënave CAHDATA të KiE-së;
- c. Në cilësinë e Anëtarit me të drejta të plota të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë dhe të Anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të saj;
- d. Në cilësinë e Anëtarit me të drejta të plota të Konferencës së Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave dhe të Anëtarit të Komitetit të Suportit dhe Akreditimit të saj. Gjithashtu, në kuadër të këtij forumi, kontribut do të jepet edhe në grupet *ad hoc* të punës, sikurse në Grupin e Punës së Planifikimit Strategjik të Konferencës Evropiane dhe në Grupin e Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Veprimtarinë Humanitare;
- e. Në cilësinë e Anëtarit të Grupit Ndërkombëtar të Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupi i Berlinit);
- f. Në cilësinë e Anëtarit me të drejta të plota të Shoqatës Frankofone të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (AFAPDP);
- g. Në cilësinë e Anëtarit me të drejta të plota të Rrjetit të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEDPA);
- h. Në cilësinë e Anëtarit të Seminarit të Trajtimit të Praktikave (Case Handling Workshop);
- i. Në cilësinë e anëtarit të Rrjetit Global të Bashkëpunimit për Zbatimin e Ligjeve të Privatësisë (GPEN), etj.

Për sa i përket shfrytëzimit të instrumenteve të ndryshëm për forcimin e kapaciteteve institucionale, Zyra e Komisionerit vijon bashkëpunimin me Instrumentin TAIEX të BE dhe Projektin JUFREX të KiE-së, në kuadër të të cilëve, gjatë vitit 2017 janë realizuar 1 Mision Ekspertësh dhe 1 Seminar.

## **10. Zhvillimin e regjistrit të të dhënave të Kontrolluesve si dhe krijimin e Regjistrit Kombëtar të kërkesave dhe përgjigjeve të Autoriteteve Publike.**

Në zbatim të këtij rekomandimi, janë hartuar;

- Projekt/Vendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” dhe relacioni shpjegues, pritët miratimi nga Këshilli i Ministrave;
- Projekt/Vendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Regjistrit elektronik të subjekteve kontrollues” dhe relacioni shpjegues, pritët miratimi nga Këshilli i Ministrave.

## B- Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga ekzekutivi gjatë periudhës së raportimit.

Gjatë vitit 2016, Komisioneri ka adresuar **10** rekomandime për institucionet publike. **3** rekomandime të standardit unifikues i drejtohen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë si dhe Organeve të Vetëqeverisjes Vendore.

Verifikimi i rekomandimeve dhënë kontrolluesve mbetet një angazhim i vazhdueshëm i Zyrës së Komisionerit. Për këtë periudhë raportimi Zyra e Komisionerit, është fokusuar në verifikimin e “Politikave të Privatësisë” në faqet online të kontrolluesve publikë dhe privatë.

Është verifikuar përmbushja e rekomandimeve të pushtetit vendor për 61 njësi të vetëqeverisjes vendore të dhëna gjatë vitit 2016 (proces në vazhdim) si dhe nga Ministria e Shëndetësisë është dokumentuar përmbushja e rekomandimit të Komisionerit.

Niveli i zbatueshmërisë të rekomandimeve të Zyrës së Komisionerit rezulton i kënaqshëm.

## C- Pasqyrat financiare, audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm, statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale, plani i veprimit të institucionit, raport ose info mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe efikasitetit të funksionit të institucionit.

### – Audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm

Në strukturën e Zyrës së Komisionerit nuk ka njësi të auditit të brendshëm. Për vitin 2017, Zyra e Komisionerit nuk është përfshirë në planin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

### – Plan i veprimit të institucionit

Publikuar në faqen zyrtare web të KDIMDP në linkun: [http://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Programi\\_i\\_punes\\_KDIMDP\\_2017.pdf](http://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/02/Programi_i_punes_KDIMDP_2017.pdf)

### - Pasqyrat financiare

**TABELA E AKORDIMIT TË BUXHETIT DHE REALIZIMIT**

**VITI 2017**

**000 / lekë**

| Nr. | EMËRTIMI                         | PLAN          | % kundrejt totalit | Fakt 12 mujor | % realizimi kundrejt planit vjetor |
|-----|----------------------------------|---------------|--------------------|---------------|------------------------------------|
| 1   | Paga                             | 36700         | 55.9 %             | 35.917        | 97.8 %                             |
| 2   | Sigurime shoqërore               | 6400          | 9.7 %              | 5.742         | 89.7. %                            |
| 3   | Mallra e shërbime të tjera       | 19660         | 29.9%              | 19206         | 97.6%                              |
| 4   | Investime                        | 2500          | 3.8. %             | 2.380         | 95 %                               |
| 5   | Transferta te buxhetet familjare | 290           | 0.4%               | 290           | 100%                               |
| 6   | <b>Kuotizacion</b>               | 100           | 0.1%               | 83            | 83 %                               |
|     | <b>Totali</b>                    | <b>65.650</b> | <b>100%</b>        | <b>63.618</b> | <b>96.9 %</b>                      |

## – Statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale

Komisioneri për vitin 2017 në respektim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është shprehur me 66 vendime, janë ankimuar 22, prej të cilave gjykata ka vendosur për 11 rrëzimin e padisë (lënien në fuqi të vendimeve të Komisionerit), 4 pranim të padisë, 5 pushimin e procesit gjyqësor, 1 revokim padie, 1 pranim të pjesshëm padie.

Komisioneri për vitin 2017 në respektim të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, është shprehur me 22 vendime. Janë ankimuar 3 vendime dhe gjykata ka vendosur lënien në fuqi të tyre.

Për shkak të ristrukturimit të Zyrës së Komisionerit në vitin 2015, janë ankimuar 6 vendime, për të cilat janë ndjekur procedurat përkatëse në dy shkallët e gjykimit administrativ. Për 5 çështje janë lënë në fuqi vendimet e Njesisë Përgjegjëse dhe për 1 çështje vijon procesi në Gjykatën Administrative të Apelit. Për asnjë rast nuk ka efekte financiare.

Vijon ndjekja e ekzekutimit të vendimeve të Komisionerit dhe njëkohësisht edhe ndjekja e proceseve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Administrativ, për çështje të mbartura.

## – Informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe efikasitetit të rritjes së kapaciteteve njerëzore në funksion të misionit të institucionit.

Zyra e Komisionerit ka përmbushur detyrimet që burojnë nga ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe sipas Kodit të Punës për punonjësit mbështetës.

### • Rekrutimi në shërbimin civil

Nëpërmjet strukturës përkatëse (Njesisë përgjegjëse) janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke respektuar parimet kryesore të këtij legjislacioni.

Gjatë vitit 2017 janë shpallur 6 procedura rekrutimit, 2 prej të cilave kanë qenë të nivelit të ulët drejtues, ndërsa janë plotësuar pjesërisht pozicionet e lira, brenda ligjit për Shërbimin Civil, për pozicionet e nivelit ekzekutiv.

### • Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë

Vlerësimi i rezultateve në punë të punonjësve dhe procesi i vlerësimit të performancës së tyre, është kryer çdo 6 muaj.

## ANEKSI 2

Në referencë të kapitullit 4 “Veprimtaria ligjore, procedurat administrative dhe gjyqësore”, të raportit vjetor, gjatë vitit 2017 Zyra e Komisionerit ka dhënë mendim për projekt aktet si më poshtë:

**Projektligjin** “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dërguar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

**Projektligjin** “Për statistikat zyrtare”, dërguar nga Kryeministria;

**Projektvendimin** “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për regjistrin elektronik shëndetësor kombëtar”, dërguar nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;

**Projektvendimin** “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore Arkiva Dixhitale e Arkivit Qëndror Teknik të Ndërtimit”, dërguar nga Ministria e Zhvillimit Urban;

**Projektvendimin** “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet administratorëve të ndërtesave të banimit, njërive administrative vendore dhe Policisë së Shtetit”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

**Projektvendimin** “Për krijimin e bazës së të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

**Projektvendimin** “Për përcaktimin e tarifave e pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

**Projektvendimin** “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 824, datë 06.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e institucioneve të autorizuar për verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, si dhe të formularit të deklarimit”, të ndryshuar;

**Projektvendimin** “Për organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, dërguar nga Kryeministria;

**Projektvendimin** “Për miratimin e rregullores ‘Për licencimin e arkivave private’, dërguar nga Kryeministria;

**Projektvendimin** për miratimin në parim të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Humbur (ICMP)”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

**Projektvendimin** “Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë “Mbi ngritjen dhe funksionimin e një qendre kontakti të përbashkët për bashkëpunim policor dhe doganor”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

**Projektvendimin** për “Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Ministrisë së Drejtësisë”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

**Projektvendimin** “Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës “Mbi parandalimin e Trafikimit të Paligjshëm të Materialeve Bërthamore dhe materialeve të tjera Radioaktive”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

**Projektmarrëveshjen e bashkëpunimit me Eurojust**, dërguar nga Ministria e Drejtësisë;

**Memorandum Mirëkuptimi** për Bashkëveprim rreth Shkeljeve Penale Doganore midis Doganave dhe Tatimeve të Mbretërisë së Bashkuar, të përbëra nga Britania e Madhe dhe Irlanda e Veriut dhe Administratës Doganore Shqiptare”, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

**Projekt/Marrëveshjen** ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës “Mbi bashkëpunimin doganor dhe ndihmën e ndërsjellë”, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

**Projekt/Marrëveshjen** “Për përhapjen e të dhënave personale të kandidatëve për studentë në IAL, për vitin akademik 2017 – 2018, nga Qendra e Shërbimeve Arsimore tek Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik”, dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

**Për përmirësimet e Kodit të Transmetimit**, miratuar me Vendimin e AMA nr.1, datë 27.01.2014, dërguar nga AMA.

Janë dhënë opinione ligjore për dokumente të rëndësishëm, ardhur nga institucione të ndryshme disa prej të cilave:

- Opinion për projektin “Transparenca e Financimit të partive politike si një mekanizëm për uljen e korrupsionit në Shqipëri”, drejtuar Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë;
- Opinion për “Publikimin e listës së kandidatëve që kanë aplikuar për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, drejtuar Avokatit të Popullit;
- Opinion “Për bërjen publike të rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit lidhur me kandidatët për institucionet e rivlerësimit”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
- Opinionin “Në lidhje me kërkesën për bërjen publike nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të dosjeve profesionale të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar te gjyqtarëve dhe prokurorëve”;
- Opinion “Në lidhje me bërjen publike nga Kuvendi i Shqipërisë të dokumenteve që provojnë përmbushjen e kriterëve ligjorë nga kandidatët e përzgjedhur si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.”;
- Opinion lidhur me kërkesën për bashkëpunim dërguar nga “Autoriteti për Informimin për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”;
- Opinion lidhur publikimin e Raporteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe respektimit të kërkesave të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, kërkuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;
- Opinion lidhur me Projektin “Mbi Regjistrin Evropian të Fibrozës Kistike” (ECFSPR) mbi bazën e të cilit synohet mbledhja, përpunimi dhe transferimi i të dhënave personale dhe sensitive të pacientëve drejt Regjistrin Evropian të Fibrozës Kistike (ECFSPR-së) në Gjermani”, dërguar nga Departamenti i Pediatrikës;
- Opinion “Për projektin e instalimit të sistemit CCTV ne zyrat e gjendjes civile”, dërguar nga Ministria e Brendshme;
- Kërkesë për rishikim opinionit “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, dërguar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financave;
- Mendim “Mbi zbatimin e planit rajonal për integrimin dixhital në vijim të Samitit të Triestes”, dërguar nga Ministri i Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike.

## ANEKSI 3

Në referencë të kapitullit 4 “Veprimtaria ligjore, procedurat administrative dhe gjyqësore” të raportit vjetor, aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara, të cilat duhet të kishin marrë më parë mendimin e Zyrës së Komisionerit.

### Ligje të cilat nuk janë paraqitur për mendim:

1. Ligji nr.17/2017, datë 16.2.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar (fz nr. 43/2017);
2. Ligji nr.18/2017, datë 23.2.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” (fz nr. 43/2017);
3. Ligji nr.42/2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar. (fz nr. 85/2017);
4. Ligji nr.40/2017, “Për disa ndryshime në ligjin nr.8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar. (fz nr.85/2017);
5. Ligji nr.55/2017, “Për ratifikimin e ndryshimit nr. 1 të Marrëveshjes së Kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria ag, lidhur me financimin e projektit “Shëndetësia elektronike në Shqipëri - regjistri mbarëkombëtar i shëndetësisë elektronike”, ratifikuar me ligjin nr. 69/2014 (fz nr. 94/2017);
6. Ligji nr.69/2017, datë 27.4.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003 “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, të ndryshuar. (fz nr.113/2017).
7. Ligji nr.90/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar (fz nr. 118/2017);
8. Ligji nr.58/2017, datë 20.4.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar (fz nr. 102/2017).

### VKM të cilat nuk janë paraqitur për mendim:

1. VKM nr.108, datë 15.2.2017 “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e fëmijëve në punë” (fz nr. 33/2017);
2. VKM nr.495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”. (fz nr. 166/2017);
3. VKM nr.534, datë 4.10.2017 “Për miratimin e raportit të nëntë, të dhjetë, të njëmbëdhjetë kombëtar periodik për zbatimin e konventës ndërkombëtare të OKB-së, “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor” (fz nr. 180/2017);